

KONTRATË SHITBLERJE KUOTE

Në Tiranë, sot në datën 29/08/2023, në selinë e shoqërisë “RENEW” SH.P.K., në adresën: Njësia Administrative Nr. 2, Rruga “Themistokli Gërmenji”, Pallati pranë RTSH, Kati I, Tiranë, u paraqitën palët e mëposhtme për të nënshkruar këtë Kontratë Shitblerje Kuote (këtu e më poshtë referuar si “**Kontrata**”):

PALA SHITËSE:

Z. Admir Bezhani, shtetas shqiptar, atësia Kosta, i datëlindjes 17/01/1976, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, në adresën: Blv. “Bajram Curri”, Pallati 6, Shk. 1, Ap. 12, Tiranë, identifikuar me Letërnjoftim ID Nr. 036165342 dhe Nr.personal H60117037R, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, këtu e më poshtë referuar si **SHITËSI**,

Jep pëlqimin Znj. Suada Koka (bashkëshortja e Z. Admir Bezhani), shtetase shqiptare, e datëlindjes 29/05/1985, lindur në Durrës dhe banuese në Tiranë, në adresën: Blv. “Bajram Curri”, Pallati 6, Shk. 1, Ap. 12, Tiranë, identifikuar me Pasaportën Nr. BF4262628 dhe Nr. personal I55529084S, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

dhe

PALA BLERËSE:

Shoqëria “ARC” SH.P.K., person juridik shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (“QKB”) në datën 28/05/2008, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) K81728025F, me seli në adresën: Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nd. 1, Tiranë, përfaqësuar në këtë Kontratë nga Administratori **Z. Zenel Hysenbegasi**, shtetas shqiptar, atësia Namik, i datëlindjes 31/12/1979, lindur në Pogradec dhe banues në Tiranë, në adresën: Rruga “Panajot Pano”, Kompleksi “Lin Konstruktion”, Shk. 3, Apt. 4/1, Yzberisht, identifikuar me Letërnjoftim ID Nr. 034895788 dhe Nr. personal H91231047K, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, këtu e më poshtë referuar si **BLERËSI**.

Në vijim Shitësi dhe Blerësi do të përcaktohen bashkërisht si “**Palët**” dhe veçmas si “**Pala**”.

Hyrje

- (A) Në datën 28/10/2020, është regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga QKB, shoqëria “RENEW” SH.P.K., me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) M02228017S, me administrator Z. Admir Bezhani, me seli në Tiranë, në adresën: Rruga “Themistokli Gërmenji”, Pallati pranë RTSH, Kati I, me objekt të veprimtarisë së saj: *“implementim i projekteve në fushën e energjisë së rinovueshme, ndërtim centralesh dhe veprave në fushën e burimeve të reja prodhuese të energjisë elektrike, si dhe prodhim dhe shitje të*

energjisë së prodhuar nga burime të rinovueshme si Fotovoltaike, Solare etj. ”, me kapital themeltar 100,000 (njëqind mijë) Lekë, me Ortak të Vetëm Z. Admir Bezhani, pronar i një kuote që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë “RENEW” Sh.p.k.

- (B) Shitësi dëshiron të shesë tek Blerësi kuotën e cila përfaqëson 100% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë “RENEW” Sh.p.k. në përputhje me kushtet dhe kërkesat e kësaj Kontrate.
- (C) Me Vendimin e Ortakut të Vetëm të shoqërisë “ARC” Sh.p.k. të datës 29/08/2023, është vendosur miratimi i blerjes së kuotës që Z. Admir Bezhani zotëron tek kapitali i shoqërisë “RENEW” Sh.p.k., në masën 100% në favor të shoqërisë “ARC” Sh.p.k.
- (D) Shitësi vendos në dispozicion të Blerësit shumat që shoqëria “RENEW” Sh.p.k. ka marrë hua nga ortaku i saj deri në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, të detajuara në Shtojcën 1 të kësaj Kontrate, me vlerë të përgjithshme të barabartë me 19,000 Euro (nëntëmbëdhjetë mijë euro) dhe 1,113,500 Lekë (një milionë e njëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind lekë) (“**Hua Ortaku**”).

Në këto kushte, Palët bien dakort për hartimin e kësaj Kontrate, me tekstin e mëposhtëm:

BAZA LIGJORE

Baza juridike e lidhjes së kësaj Kontrate janë nenet 72, 73, 74 të Ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, nenet 6, nenet 84-90, 705-756 të Kodit Civil, neni 74 i Kodit të Familjes.

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate dhe në përputhje me kushtet dhe afatet e parashikuara në të, Shitësi i shet dhe i transferon Blerësit, kuotën e tij e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë “RENEW” Sh.p.k., bashkë me të gjithë të drejtat dhe titujt që rrjedhin nga shitja e saj, dhe Blerësi e pranon dhe blen këtë kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë “RENEW” Sh.p.k., duke paguar çmimin sipas kësaj Kontrate.
- 1.2 Shitësi deklaron dhe garanton se kuota është tërësisht e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë siguruese, detyrim, garanci apo çdo e drejtë tjetër në favor të të tretëve.

NENI 2

ÇMIMI I KONTRATËS

- 2.1 Çmimi i shitjes së kuotës që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë “RENEW” SH.P.K. nga Shitësi në favor të Blerësit është 120,000 EURO (njëqind e njëzetë mijë euro) (në vijim referuar si “**Çmimi**”).



- 2.2 Çmimi do të paguhet nga Blerësi në llogarinë bankare të Shitësit brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate nga Palët.

NENI 3

FITIMI I PRONËSISË SË KUOTËS

- 3.1 Palët bien shprehimisht dakort se titulli i pronësisë mbi kuotën do të transferohet nga Shitësi tek Blerësi pasi Blerësi t'i ketë paguar Shitësit Çmimin sipas nenit 2.1 më sipër.
- 3.2 Palët kontraktore pranojnë se me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe pagesën e Çmimit nga Blerësi, Shitësi heq dorë nga pronësia e kuotës së shitur dhe nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me kuotën e shitur dhe se pas realizimit të kësaj Kontrate dhe regjistrimit të saj në QKB, Blerësi do të bëhet pronar i ligjshëm i një kuote me vlerë 100% të kapitalit të shoqërisë "RENEW" Sh.p.k.
- 3.3 Palët deklarojnë se nëse brenda afatit të parashikuar në nenin 2.2 më sipër, Blerësi nuk i paguan Shitësit Çmimin, Kontrata do të zgjidhet dhe si rrjedhim, nuk do të prodhojë asnjë efekt ligjor në lidhje me transferimin e titullit të pronësisë së kuotës nga Shitësi tek Blerësi.
- 3.4 Me qëllim regjistrimin e kësaj Kontrate pranë QKB, Palët bien dakort dhe pranojnë se do të jetë e mjaftueshme të depozitohet në QKB mandati bankar që vërteton pagesën e Çmimit në favor të Shitësit.
- 3.5 Palët njohin dhe pranojnë se, shoqëria "RENEW" Sh.p.k. do t'i ripaguajë Shitësit Huanë e Ortakut brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike nga lidhja e kësaj Kontrate. Shitësi deklaron dhe pranon se, pas shlyerjes së Huasë së Ortakut, shoqëria "RENEW" Sh.p.k. nuk do të ketë asnjë detyrim financiar kundrejt tij.

NENI 4

TË NDRYSHME

- 4.1 Llogaria bankare e Shitësit ku do të bëhen pagesat e parashikuara në këtë Kontratë është si më poshtë:

Banka: Raiffeisen Bank Sh.a.

Numri i Llogarisë Bankare: 2800953578 dhe IBAN Nr. AL86202111230000002800953578 në EUR

- 4.2 Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera ndërmjet Palëve duhet të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen në adresat përkatëse të Shitësit dhe të Blerësit, nëpërmjet letrës rekomande me kthim përgjigje ose postës elektronike.
- 4.3 Çdo njoftim do të jetë i vlefshëm vetëm nëse verifikohen kushtet vijuese: (a) nëse është dërguar me postë elektronike, në momentin në të cilin është marrë posta elektronike; (b)

3



nëse është dërguar me letër rekomande, në datën e dorëzimit tek marrësi që do të vërtetohet me fletën e kthimit.

NENI 5 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

5.1 Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj Kontrate. Nëse një zgjidhje e tillë nuk është e mundur, mosmarrëveshja do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 6 DOKUMENTACIONI DHE HARTIMI I KONTRATËS

6.1 Kësaj Kontrate i bashkëlidhen:

- Shtojca 1: Lista e huave të dhëna nga Ortaku i Vetëm për shoqërinë “RENEW” Sh.p.k.;
- Vendimi i Ortakut të Vetëm të shoqërisë “ARC” Sh.p.k. datë 29/08/2023;
- Dokumentat identifikuese të Palëve.

Kontrata bëhet e vlefshme me nënshkrimin e saj nga Palët. Kjo Kontratë u hartua në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë juridike.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI

Z. Admir Bezhani

Admir Bezhani

Dhënës i pëlqimit

Znj. Suada Koka

Suada Koka

BLERËSI

Shoqëria “ARC” SH.P.K.

Përfaqësuar nga

Z. Zenel Hysenbegasi

Administrator

Zenel Hysenbegasi



SHTOJCA 1

Lista e huave të dhëna nga Ortaku i Vetëm për shoqërinë “RENEW” Sh.p.k.

Data	Përshkrimi i veprimit	Shuma e huasë në Euro	Shuma e huasë në Lekë
20.11.2020	Derdhje nga ortaku		613,500
A	Total 2020	-	613,500
20.10.2021	Derdhje nga ortaku		70,000
21.10.2021	Derdhje nga ortaku		430,000
B	Total 2021	-	500,000
19.01.2022	Derdhje nga ortaku	2,500	
20.04.2022	Derdhje nga ortaku	2,500	
17.06.2022	Derdhje nga ortaku	3,000	
09.08.2022	Derdhje nga ortaku	3,000	
C	Total 2022	11,000	-
20.01.2023	Derdhje nga ortaku	3,000	
28.03.2023	Derdhje nga ortaku	5,000	
D	Total 2023	8,000	
	Totali A+B+C+D	19,000	1,113,500

SHTOJCË KONTRATE SHITBLERJE KUOTE

Në Tiranë, sot në datën 11/09/2023, në selinë e shoqërisë “RENEW” SH.P.K., në adresën: Njësia Administrative Nr. 2, Rruga “Themistokli Gërmenji”, Pallati pranë RTSH, Kati I, Tiranë, u lidh kjo Shtojcë Kontrate Shitblerje Kuote (këtu e më poshtë referuar si “**Shtojcë Kontrate**”):

PALA SHITËSE:

Z. Admir Bezhani, shtetas shqiptar, atësia Kosta, i datëlindjes 17/01/1976, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, në adresën: Blv. “Bajram Curri”, Pallati 6, Shk. 1, Ap. 12, identifikuar me Letërnjoftim ID Nr. 036165342 dhe Nr.personal H60117037R, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, këtu e më poshtë referuar si **SHITËSI**,

Jep pëlqimin Znj. Suada Koka (bashkëshortja e Z. Admir Bezhani), shtetase shqiptare, e datëlindjes 29/05/1985, lindur në Durrës dhe banuese në Tiranë, në adresën: Blv. “Bajram Curri”, Pallati 6, Shk. 1, Ap. 12, identifikuar me Pasaportën Nr. BF4262628 dhe Nr. personal I55529084S, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

dhe

PALA BLERËSE:

Shoqëria “ARC” SH.P.K., person juridik shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (“QKB”) në datën 28/05/2008, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) K81728025F, me seli në adresën: Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nd. 1, Tiranë, përfaqësuar në këtë Kontratë nga Administratori **Z. Zenel Hysenbegasi**, shtetas shqiptar, atësia Namik, i datëlindjes 31/12/1979, lindur në Pogradec dhe banues në Tiranë, në adresën: Rruga “Panajot Pano”, Kompleksi “Lin Konstruksion”, Shk. 3, Apt. 4/1, Yzberisht, identifikuar me Letërnjoftim ID Nr. 034895788 dhe Nr. personal H91231047K, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, këtu e më poshtë referuar si **BLERËSI**.

Në vijim Shitësi dhe Blerësi do të përcaktohen bashkërisht si “**Palët**” dhe veçmas si “**Pala**”.

MEQËNËSE:

- (A) Në datën 29/08/2023, Shitësi dhe Blerësi kanë nënshkruar një Kontratë Shitblerje Kuote (në vijim referuar si “Kontrata”) nëpërmjet të cilës Shitësi i shet dhe i transferon Blerësit, kuotën e tij e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë “RENEW” Sh.p.k. identifikuar me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) M02228017S, bashkë me të gjithë të drejtat dhe titujt që rrjedhin nga shitja e saj, dhe Blerësi e pranon dhe blen këtë kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë “RENEW” Sh.p.k.;



- (B) Palët bien dakort të ndryshojnë Kontratën, në përputhje me kushtet që vijnë në këtë Shtojcë Kontrate;

Pra, meqënëse ekzistojnë këto kushte paraprake, Palët bien dakord përsa vijon:

NENI 1

OBJEKTI I SHTOJCËS SË KONTRATËS

- 1.1 Nëpërmjet kësaj Shtojce Kontrate, Palët bien dakort që të ndryshohet Neni 2 i Kontratës, teksti i të cilit do të lexojë si më poshtë vijon:

“Neni 2

Çmimi i Kontratës

- 2.1 Çmimi i shitjes së kuotës që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë “RENEW” SH.P.K. nga Shitësi në favor të Blerësit është 120,000 EURO (njëqind e njëzetë mijë euro) (në vijim referuar si “**Çmimi**”).
- 2.2 Çmimi do të paguhet nga Blerësi në llogarinë bankare të Shitësit me disa këste si vijon:
- (i) shuma prej 50,000 Euro (pesëdhjetë mijë euro) do të paguhet nga Blerësi brenda datës 15 Shtator 2023;
 - (ii) shuma prej 70,000 Euro (shtatëdhjetë mijë euro) do të paguhet nga Blerësi brenda datës 31 Dhjetor 2023.”

- 1.2 Në vijim të Nenit 1.1 më sipër, Palët bien dakort që të ndryshohet Neni 3 i Kontratës, teksti i të cilit do të lexojë si më poshtë vijon:

“Neni 3

Fitimi i Pronësisë së Kuotës

- 3.1 Palët bien shprehimisht dakort se titulli i pronësisë mbi kuotën do të transferohet nga Shitësi tek Blerësi pasi Blerësi t'i ketë paguar Shitësit një pjesë të Çmimit të përcaktuar në pikën (i) të nenit 2.2 më sipër.
- 3.2 Palët kontraktore pranojnë se me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe pagesën e një pjese të Çmimit nga Blerësi sipas përcaktimeve të nenit 2.2 (i), Shitësi heq dorë nga pronësia e kuotës së shitur dhe nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me kuotën e shitur dhe se pas realizimit të kësaj Kontrate dhe regjistrimit të saj në QKB, Blerësi do të bëhet pronar i ligjshëm i një kuote me vlerë 100% të kapitalit të shoqërisë “RENEW” Sh.p.k.
- 3.3 Me qëllim regjistrimin e kësaj Kontrate pranë QKB, Palët bien dakort dhe pranojnë se do të jetë e mjaftueshme të depozitohet në QKB mandati bankar që vërteton pagesën e një pjese të Çmimit në favor të Shitësit sipas nenit 2.2 (i) më sipër.



3.4 Palët njohin dhe pranojnë se, shoqëria “RENEW” Sh.p.k. do t’i ripaguajë Shitësit Huanë e Ortakut brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike nga lidhja e kësaj Kontrate. Shitësi deklaron dhe pranon se, pas shlyerjes së Huasë së Ortakut, shoqëria “RENEW” Sh.p.k. nuk do të ketë asnjë detyrim financiar kundrejt tij.”

NENI 2 TË NDRYSHME


- 2.1 Të gjitha kushtet e tjera të Kontratës, përveç sa ndryshuar me këtë Shtojcë Kontrate, do të vazhdojnë të jenë të pandryshuara dhe të prodhojnë efektet e tyre ligjore edhe në lidhje me këtë Shtojcë Kontrate.
- 2.2 Kjo Shtojcë Kontrate i bashkëngjitet Kontratës si pjesë e pandarë e saj. Kontrata dhe kjo Shtojcë Kontrate do të lexohen dhe interpretohen si një dokument i vetëm.
- 2.3 Në këtë Shtojcë Kontrate, fjalët që fillojnë me gërma kapitale do të kenë të njëjtin kuptim që përcaktohet në Kontratë, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe ose është parashikuar ndryshe.
- 2.4 Kjo Shtojcë Kontrate do të hyjë në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja Palët.
- 2.5 Kjo Shtojcë Kontrate do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Kjo Shtojcë Kontrate Nr. 1 u nënshkrua nga Palët sot më datë 11/09/2023 në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë juridike.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI

Z. Admir Bezhani



Dhënës i pëlqimit

Znj. Suada Koka



BLERËSI

Shoqëria “ARC” SH.P.K.

Përfaqësuar nga

Z. Zenel Hysenbegasi

Administrator

